



KONFERENCA E XVII NDËRKOMBËTARE – DITA BOTËRORE E FILOZOFISË

FILOZOFIA AMERIKANE

Folësit e konfirmuar – ligjërues kryesor / ligjërues të shquar

Philip Kitcher – *John Dewey Professor of Philosophy, Emeritus, Columbia University*

Bjørn Torgrim Ramberg – *Professor at Department of Philosophy, Classics, History of Art and Ideas (IFIKK), University of Oslo*

Lee Braver – *Professor at Department of Philosophy, University of South Florida*

Magnus Schlette – *Professor at Heidelberg University*

Sarin Marchetti – *Dipartimento di Filosofia Department of Philosophy, The Sapienza University of Rome*

Ligjërues të nderi:

Astrit Salihu – *Professor at Department of Philosophy, University of Pristina*

Organizuar nga: *Departamenti i Filozofisë në Universitetin e Prishtinës; Shoqata e Filozofëve të Kosovës; Asociacioni Evropian i Pragmatizmit; Federata Ndërkombëtare e Shoqatave Filozofike*

Thirrje për paraqitjen e kumtesave

Koha moderne karakterizohet nga zbulimi i Kontinentit të Ri, i cili në diskursin filozofik të periudhave të ndryshme nuk është konceptuar vetëm si një zgjerim gjeografik, por si një hapësirë potenciale për zhvillimin e një mënyre të re të menduarit praktik dhe kontemplativ. Alexis de Tocqueville e vlerësoi Revolucionin Amerikan në dallim nga ai francez, duke e interpretuar si një shprehje më autentike të demokracisë, ndërsa Georg Wilhelm Friedrich Hegel argumentonte



se e ardhmja e zhvillimit filozofik dhe historik do të zhvendosej drejt Kontinentit të Ri. Në mënyrë të ngjashme, Jean Baudrillard e konceptualizonte Amerikën si një formë të utopisë transatlantike të modernitetit të vonë. Megjithatë, këto interpretime nuk e reduktojnë Amerikën në një hapësirë pasive të projeksioneve evropiane, as nuk e përkufizojnë atë si një entitet të privuar nga vetë-reflektimi. Përkundrazi, filozofia amerikane, duke u mbështetur në trashëgiminë intelektuale evropiane – *crème de la crème*-in e saj – artikulon një traditë të veçantë dhe autentike të mendimit filozofik. Kjo traditë fillon me transcendentalizmin e Ralph Waldo Emerson dhe Henry David Thoreau, ku Emerson mund të lexohet si figurë proto-pragmatike, dhe më pas zhvillohet drejt konsolidimit të pragmatizmit klasik. Kjo traditë kulmon në veprën e Charles Sanders Peirce, William James dhe John Dewey, të cilët rikonfigurojnë hartën e filozofisë perëndimore përmes një paradigme post-metafizike të mendimit. Në këtë kuadër, elementë si empirizmi radikal, eko-etika, pluralizmi, darvinizmi hegelian dhe demokracia etike kontribuojnë në formësimin e asaj që njihet si filozofia amerikane, e cila artikullohet nën kornizën konceptuale të pragmatizmit. Në këtë paradigme, liria, pluralizmi dhe demokracia nuk trajtohen si kategori rastësore, por si kushte konstitutive të vetë praktikës filozofike. Në këtë kuptim, pragmatizmi shënon një zhvendosje nga primati i teorisë drejt praktikës, nga praktika drejt riformulimit teorik, si dhe nga teoria e së vërtetës drejt një teorie për të vërtetën (Rorty).

Pas Luftës së Dytë Botërore, filozofia amerikane dominohet nga tradita anglo-saksone e filozofisë analitike, e cila e lë në margjinë pragmatizmin klasik. Duhet të pritët deri në vitet 1970 që kjo traditë të rishfaqet në formën e neo-pragmatizmit ose pragmatizmit lingvistik. Figurat kryesore të këtij ri-dizajni janë Richard Rorty dhe Hilary Putnam, të mbështetur më pas nga Richard Bernstein me një orientim më politik, si dhe nga Robert Brandom në një linjë më epistemologjike dhe inferencialiste.



Përveç pragmatizmit si traditë qendrore e filozofisë amerikane, paralelisht në vitet e pas-luftës së dytë botërore zhvillohet edhe eko-etika e Aldo Leopold, e cila mund të vendoset në kuadrin më të gjerë të bioetikës së Van Rensselaer Potter.

Në të njëjtën kohë, filozofia e teknologjisë zhvillohet fillimisht nga premiset evropiane me Martin Heidegger dhe Jacques Ellul, ndërsa këto premisa zhvillohen më tej me Shoqatën e Filozofisë së Teknologjisë, e cila u formua në Amerikë. Një nga drejtimet kryesore në këtë qasje është post-fenomenologjia, që përfaqëson një nga qasjet më të rëndësishme të kthesës empirike në studimin e teknologjisë.

Një tjetër dimension qendror është filozofia e së drejtës dhe teoria politike, ku John Rawls dhe Ronald Dworkin përfaqësojnë dy nga figurat paradigmatiche të mendimit normativ bashkëkohor. Po ashtu, zhvillohet edhe tradita e filozofisë së artit dhe kritikës letrare, ku Harold Bloom, Arthur Danto dhe George Dickie riformulojnë debatin mbi kanonin, art-botën dhe “fundin e artit”.

Në përgjithësi, pragmatizmi ka funksionuar si një hapësirë dialogu e pluri-perspektivizmi. Siç thekson William James, ajo mund të kuptohet si një “banesë me shumë dhoma”, ku tradita të ndryshme filozofike bashkëjetojnë në dialog të vazhdueshëm. Në këtë kuptim, filozofia amerikane shfaqet si një proces i hapur dhe i papërfunduar reflektiv, i cili artikullohet përmes dialogut me tradita të ndryshme si fenomenologjia, filozofia analitike, strukturalizmi/post-strukturalizmi, shkolla e Frankfurtit dhe hermeneutika. Kjo hapje metodologjike dhe pluraliste e bën pragmatizmin një nga traditat më të qëndrueshme dhe më përfshirëse të filozofisë bashkëkohore. Në këtë kuptim, filozofia amerikane nuk reduktohet në një doktrinë të vetme, por duhet kuptuar si një horizont i përbashkët ku respektohen liria, pluralizmi dhe dialogu i pafundëm.




Temat qendrore të konferencës:

- Natyra në traditën amerikane: Emerson, Whitman, Thoreau, James dhe Leopold
- Konsekuencat e triadës pragmatiste: Peirce, James dhe Dewey
- Epistemologjia në traditën analitike
- Epistemologjia dhe ontologjia në pragmatizëm
- Ontologjia sociale e neo-pragmatizmit
- Bioetika në kontekstin amerikan
- Neo-pragmatizmi
- Hegeli dhe pragmatizmi
- Kanti dhe pragmatizmi
- Heidegger dhe pragmatizmi
- Wittgenstein dhe pragmatizmi
- Nietzsche dhe pragmatizmi
- Trashëgimia pragmatiste në kontekstin evropian: Habermas, Apel, Joas dhe Forst
- Filozofia e teknologjisë në kontekstin amerikan
- Post-fenomenologjia
- Filozofia e së drejtës në kontekstin amerikan
- Estetika: “bota e artit” dhe “fundit i artit”



- Kritika letrare dhe filozofia e letërsisë në kontekstin amerikan
- Kinemaja dhe filmi në kontekstin amerikan
- Liberalizmi dhe filozofia amerikane
- Sfidat e demokracisë
- Teoria politike amerikane
- Teoria sociale amerikane
- Teoria antropologjike amerikane
- Ridefinimi i arkitekturës dhe qytetit në kontekstin amerikan





Udhëzime dhe Informata të Përgjithshme për Konferencën

- Për çdo aplikim kërkohen: titulli, një abstrakt prej 200–400 fjalësh, pesë fjalë kyçe dhe afiliacioni institucional i autorit.
- Punimet që do të prezantohen duhet të jenë të shkruara në gjuhën shqipe ose angleze.
- Të gjitha abstraktet duhet të dërgohen përmes emailit në adresat vijuese:
labinot.kelmendi@uni-pr.edu ; shfk.kosova@gmail.com
- Abstraktet do të shqyrtohen dhe përzgjidhen nga Komiteti Shkencor i Konferencës.

DATA TË RËNDËSISHME:

- **Afati i fundit për dorëzimin e abstrakteve:** 1 shtator
- **Njoftimi për pranimin:** 10 shtator
- **Datat e konferencës:** 19–20¹ nëntor 2026

Konferenca do të mbahet në format hibrid: do të mundësohet pjesëmarrja si fizike ashtu edhe online.

1970 MCMLXX

¹ Varësisht nga dinamika dhe mundësitë organizative, konferenca mund të zgjasë një ose dy ditë; megjithatë, punimet do të mbahen patjetër më 19 nëntor.